

COVID-19 | Maatregelen | 08/05/2021

Albanees | Vertaald uit het Nederlands

Masat që merren nga 8 maji

Hyrje

Qeveria ka vënë rregulla për të ndaluar koronavirusin. Respektoji rregullat! Kështu ti nuk sëmuresh, apo nuk mund të sëmuresh asnjëri. Policia mund të të kontrollojë.

Vini re: Disa qytete/bashki dhe komuna kanë rregulla shtesë. Shiko faqen e internetit të qytetit/bashkisë apo të komunës.

Rregullat shumë të rëndësishme

- Laji shpesh duart e tua me ujë dhe sapun!
- Vendos/mbaj një maskë për gojë!
- Mbaj minimumi 1,5 metra distancë nga personat e tjerë!
- Mbaj kontakt të afërt me maksimumi 1 person ! Nuk është e nevojshme të mbash 1,5 metra distancë me personin me të cilin ke kontakt të afërt.
- Bëj kujdes edhe më tepër tek njerëzit e rrezikueshëm :
 - njerëzit më të moshuar se 65 vjeç,
 - njerëzit me probleme të zemrës, të mushkërive apo të veshkave,
 - njerëzit që infektohen lehtësisht.
- Puno nga shtëpia!
- Ajros mirë : hapi dritaret !
- Është mira t'a lësh të takohesh me të tjerë përjashta.

Të shkosh në një qytet apo shtet tjetër

- Në Belgjikë :
 - Lejohet të udhëtosh kudo.
 - Nëse ti përdor transportin publik (autobus, tramvaj apo tren) dhe nëse ti ke moshë më të madhe se 12vjeç :
 - ▶ atëherë ti duhet mbash një maskë për gojë. Kjo është e detyrueshme.
 - Nga ora 24 e natës deri në ora 5 e mëngjesit lejohet të dilni në rrugë me maksimumi 3 persona bashkë.
 - ▶ Fëmijët deri dhe përfshi 12 vjeç nuk llogariten.
 - ▶ Ti lejohet të dalësh në rrugë bashkë me personat me të cilët bashkëjeton. Në këtë rast lejohet të jeni me më shumë se 3 persona bashkë. Ky është një përjashtim.

- Udhëtime jashtë shtetit :
 - Është mira të mos udhëtosh jashtë shtetit.
 - Nëse megjithatë duhet të udhëtosh jashtë shtetit, atëherë janë 3 kode me ngjyra :
 - ▶ Kuq: rajon ose shtet ku ti ke një rrezik të madh për koronavirus. Mos udhëto për në këta vende.
 - ▶ Portokalle: rajon ose shtet ku ti ke një rrezik të mesëm për koronavirus. Është mira të mos udhëtosh për në këta vende.
 - ▶ Jeshil/ e gjelbër: rajon ose shtet ku ti ke një rrezik të vogël për koronavirus. Ti mund të udhëtosh për në këta vende.
 - ▶ Shiko tek faqja e internetit <https://www.info-oronavirus.be/nl/kleurcodes-per-land/>
 - Shiko në diplomatie.belgium.be se cilat rregulla janë në shtetin ku ti do të shkosh!
- Udhëtimi/kthimi për në Belgjikë
 - Ishe në udhëtim jashtë shtetit për më gjatë se 48 orë?
 - ▶ Plotëso formularin në: <https://travel.info-coronavirus.be/nl/public-health-passenger-locator-form> para se të kthehesh në Belgjikë!
 - ▶ Nëse merr një SMS atëherë është e detyrueshme të rrish në karantinë. Ti duhet të rrish në shtëpi për minimumi 7 ditë. Në ditën e 1-rë dhe në ditën e 7-të të bëhet një test për koronavirus. Nëse nuk merr një SMS, atëherë nuk duhet të rrish në karantinë.
 - ▶ Vini re: ty mund të të vihet një gjobë prej 250 eurosh nëse nuk e bën këtë.
 - Nëse ti nuk banon në Belgjikë dhe vjen në Belgjikë, atëherë ti duhet të bësh një test për koronavirus jo më gjatë se 72 orë para se të vish në Belgjikë. Rezultati duhet të jetë negativ.

Punë

- Puno nga shtëpia! Kjo është e detyrueshme.
- Nëse ti megjithatë duhet të shkosh në punën tënde për të punuar, atëherë
 - Ti duhet të vendosësh/mbash një maskë për gojë.
 - Ajros mirë : hapi dritaret !
- Nëse ke pyetje, merr informacione nga shefi yt.

Dyqanet

- Dyqanet janë hapur.
 - Lejohet të shkosh në dyqan bashkë me maksimumi një person tjetër. Ky duhet të jetë një person me të cilin bashkëjeton.
 - Nëse hyn në dyqan, atëherë dizinfektoi më parë duart e tua!
 - Lejohet të bësh blerjen (të rrish brenda dyqanit) për maksimumi 30 minuta.
 - Vendos/mbaj një maskë për gojë! Kjo është e detyrueshme.
- Ka tregje (tregjet hapur).
- Dyqani i natës është hapur deri në ora 22:00 e mbrëmjes.
- Berberët/floktoret dhe profesionet e tjerë jomjeksor të kontaktit (të afërt) janë hapur. Për shembull : pedikyrë, specialistët e bukurisë.

Hotel restaurant kafe

- Ti mund të shkosh të marrësh ushqime deri në ora 22:00 e mbëmjes.
- Kafetë dhe restorantët janë të hapur nga ora 08:00 e mëngjesit deri ora 22:00 e mbrëmjes.
 - Lejohet të ulesh vetëm në amjentet e jashtëm (tarraca).
 - Lejohet të ulesh në tavolinë me maksimumi 4 persona bashkë. Ose me njerëzit me të cilët ti bashkëjeton.
 - Ti duhet të rrish ulur pranë tavolinës! Ti nuk duhet të mbash maskë për gojë.
 - Nëse duhet të shkosh në WC, atëherë duhet të mbash një maskë për gojë!

Kontakt social

- Lejohet të kesh kontakte të afërt me maksimumi 1 të njëjtin person. Në këtë rast 1,5 metra distancë nuk është e nevojshme.
- Nëse fton dikë në shtëpinë tënde, atëherë
 - lejohet të presësh 2 persona në të njëjtin moment. Ata duhet të jenë dy persona të cilët bashkëjetojnë me njëri-tjetrin.
 - Fëmijët deri dhe përfshi 12 vjeç nuk llogariten.
 - Ti duhet të mbash 1,5 metra distancë me përjashtim të personave me të cilët ti ke kontakt të afërt.
- Lejohet të jeni përjashta në një grup prej maksimumi 10 personash. Ti duhet të mbash 1,5 metra distancë. Fëmijët deri dhe përfshi 12 vjeç nuk llogariten.

Lëvizje / aktivitet fizik

- Lejohet të bëhet sport përjashta me maksimumi 10 persona bashkë. Mbaj 1,5 metra distancë!
- Nëse bën sport në një klub apo shoqatë atëherë:
 - Lejohet të jeni me maksimumi 25 persona bashkë.
 - Kjo lejohet vetëm përjashta. Për fëmijët deri dhe përfshi 12 vjeç kjo lejohet në ambjentet e brendshëm me maksimumi 10 fëmijë bashkë.
 - Duhet gjithmonë të jetë i pranishëm një trajner apo shoqërues.
 - Nuk lejohet të ketë publik.
- Jacuzzi-t, kabinat me avull dhe hamamët, pistat e skive dhe qendrat e fitnesit janë mbyllur.
- Pishinat janë hapur.

Koha e lirë

- Çfarë është hapur?
 - Bibliotekat
 - Këndet e lojrave përjashta
 - Muzeumet
 - Parqet zoologjikë (me kafshë)
 - Parqet e pushimeve, parqet me shtëpi pushimi, me shtëpi njëkatëshe dhe kampingjet
 - Parqet tematikë (me lojra)

- Vendet e tjerë janë mbyllur. Për shembull kinematë apo kazinotë.
- Lejohen aktivitete/evenimentë apo shfaqje. Për shembull: teatër, ndeshje të sportistëve profesionistë apo koncerte.
 - Këta lejohen me maksimumi 50 persona.
 - Ti duhet të ulësh.
 - Kjo lejohet vetëm përjashta.
- Aktivitetet e organizuar (për shembull një klub apo shoqatë) lejohen me maksimumi 25 persona.
 - Kjo lejohet vetëm përjashta. Për fëmijët deri dhe përfshi 12 vjeç këta lejohen të bëhen në ambjentet e brendshëm me maksimumi 10 fëmijë.
 - Duhet gjithmonë të jetë i pranishëm një trajner apo shoqërues.
 - Nuk lejohet të ketë publik.
 - Nuk lejohet të qëndrohet për të fjetur aty.

Besim fetar

- Shërbimet fetare lejohen
 - Këta lejohen në ambjentet e brendshëm me maksimumi 15 persona, ose përjashta me maksimumi 50 persona.
 - Fëmijët deri dhe përfshi 12 vjeç dhe shërbyesi fetar (për shembull : prifti apo imami/hoxha) nuk llogariten.
 - Ceremonitë e varrimit lejohet të bëhen në ambjentet e brendshëm me maksimumi 50 persona ose maksimumi 1 person për 10 metra katror.
 - Nuk lejohet të ofrohet ushqim më pas.

Çerdhe dhe shkolla

- Çerdhet janë hapur.
- Fëmijët mund të kthehen në shkollë. Shkolla jote të jep informacione të mëtejshëm.

Inkurajim / nxitje

Këta rregulla janë të rëndësishme për shëndetin e gjithësecilit. Gjithësecili duhet t'i rrespektojë ato.

Faleminderit që do të bësh këtë gjë! Së bashku, ne e ndalojmë koronavirusin.